

# Agjencioni për ushqim dhe veterinarë

## **Thirrje publike Nr1/2015**

Për kryerjen e aktiviteteve me interes publik nga lëmia e mbrojtjes shëndetsore të kafshëve.

Në bazë të nenit 40 paragrafi (8) nga ligji për shëndetsi veterinarë (Gaz.Zyrtare R.M nr. 113/07, 24/11, 136/11 dhe 123/12)dhe123/15)

Agjencioni për ushqim dhe veterinarë shpall thirrje publike për kryerjen e aktiviteteve me interes publik nga lëmia e mbrojtjes shëndetsore të kafshëve.

### **1. Lenda e thirrjes publike**

Lendë e kësaj thirrje publike është autorizimi i subjekteve juridike(ambulanta.klinika spitale dhe shërbimet veterinarë nëpër ferma të cilat janë të regjistruara por nuk kanë marrë pjesë në thirrjen publike të viti 2013 konform nenit 40 (8) të ligjit për shëndetsi veterinarë që të kryejnë shërbimet veterinarë me karakter publik në pajtueshmëri me ligjin për shëndetsi veterinarë, ligjin për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, urdhëresat vjetore për mbrojtjen shëndetsore të kafshëve, si dhe masa të tjera preventivi dhe çrënjosje të sëmundjeve ngjitëse që do të monitorohen nga agjencioni i ushqimit dhe i veterinarisë.

Thirrja ka të bëjë me të gjitha njësitë epizootologjike-- komunat në R.M.

### **2. Kushtet për paraqitje në thirrjen publike**

#### **2.1 Te drejtën në pjesëmarrje**

2.1.1 Te drejtë pjesëmarrje kanë të gjitha subjektet juridike me veprimtari të regjistruara- veprimtari shëndetsore veterinarë: ambulanta veterinarë, klinika ose stacione, spitale dhe shërbime veterinarë në ferma, të cilat i plotësojnë kushtet për kryerjen e veprimtarive shëndetsore veterinarë të cilat janë të regjistruara

pas thirjes publike të viti 2013. Ne thirje publike mund të paraqiten subjektet juridike të regjistruara për kryerjen e veprimtarive shëndetsore veterinarë perfundimisht me shpalljen e thirjes.

2.1.2 Afati i fundit për dorezimin e aplikimeve është 08.10.2015 në ora 14:00

## **2.2 Dokumentet e nevojshme për aplikim**

2.2.1 Aplikimi për interes ( formulari. 1)

2.2.2 Dokumente për gjendjen juridiko-ekonomiko financiare dhe profesionale. Si dëshmi për gjendjen juridiko-ekonomiko financiare dhe profesionale ofertuesi duhet të sigurojë këto dokumenta:

2221. Vendim për leje veterinaro- sanitare për përdorimin e objektit.

2222. Verbal të nënshkruar nga veterinarë i autorizuar i subjektit juridik për secilin objekt me të cilin subjekti juridik aplikon (formulari. 2)

2223. Dokument nga regjistri qendror i R.M për veprimtarinë regjistruar veterinarë shëndetsore.

2224. Gjendja Personale

Në 5 vitet e fundit ofertuesi nuk ka qenë i dënuar me vendim të plotfuqishëm në organizata kriminale, korupsion, mashtrim si dhe pastrim parash.

Ofertuesi të mos ket qenë i dënuar gjatë : tenderimeve publike, dhënien e kontratave të furnizimit publik, dhe kontrata për partneritet publiko-privat.

Ofertuesi të mos ket ndalesë të përkohshme ose të përhershme në veprimtarinë profesionale.

Ofertuesi të mos jetë në procedurë falimentimi ose likuidimi

Ofertuesi duhet të ket të paguara të gjitha detyrimet (tatimet, kontributet ose të dhënat tjera publike ose mund të prolongoj pagesat vetëm nëse ka marrëveshje paraprake me operatorin ekonomik që obligimet të kryej me vonesë.

Ofertuesi të mos ket ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës ose ndalesë për kryerjen e veprimtarisë së caktuar.

Ofertuesi është i detyruar të japë të dhëna të sakta dhe të paraqesë informacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktues

2225. Dëshmi se me vendim gjygsor nuk është shqyrtuar masë sigurie – ndalës për kryerje të veprimtarive për çdo bartës të verpimtarisë (mjek i mjeksisë veterinare), me të cilin ofertues paraqitet në konkurs, e lëshuar nga Gjygi themelor kompetent

2226 Deklarat nga personi përgjegjës për besueshmerinë e të dhënave nga aplikimi (formulari 3).

Të gjitha dokumentet që dorëzohen duhet të jenë në formë origjinale apo si kopje e vertetuara në noter. Të gjitha dokumentet përveç vendimit nga drejtoria e veterinars rrespektivisht agjencionit për ushqim dhe veterinari për leje veterinaro-sanitare për përdorim të objektit nuk **duhet të jenë me të vjetra se 6 muaj.**

Shpërndarja e shoqërive veterinare kryhet kur furnizuesi do të kontrollojë gjendjen juridiko-ekonomike-financiare si dhe aftësinë profesionale të aplikantit për kryerjen e aktiviteteve.

### **2.3. Përjashtim nga procedura e mëtutjeshme.**

Nga pjesëmarrja në procedurë të mëtutjeshme të thirrjes publike do të eliminohen aplikantët të cilët nuk i plotsojnë kriteret prej pikave 2.1 dhe 2.2.

-Nuk i plotëson kushtet në bazë të rregullores për objektin, hapësirat, paisjet instrumentet dhe kushtet higjienike që duhet të plotësojnë objektet: e ambullantave veterinare, stacioneve veterinare si dhe spitalet veterinare (Gazeta zyrtare e R.M nr 17/99) dhe rregullores për kushtet që duhet të plotësojë shërbimi veterinar në ferme (Gazeta zyrtare e R.M nr 54/08).

## **3. Mënyra e Aplikimit**

I gjithë dokumentacioni duhet të dorëzohet në mënyrë të rregullt me zarfe të mbyllura me shenjë “MOS E HAP” për thirrjen publike numër 01/2015. Dokumentacioni dorëzohet në agjencion për ushqim dhe veterinari, rruga Brigada e III Maqedone nr. 20. 1000-Shkup. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Aplikimet për interes duhet të dorëzohen në kopje origjinale të vertetuara dhe të nënshkruara (secila faqe) nga ana e personit përgjegjës të aplikantit.

Aplikacionet që nuk janë të dorëzuara në afatin e paraparë, si dhe ata që nuk janë të pregaditura sipas prepozicioneve të thirrjes publike nuk do të shqyrtohen.

Hapja e ofertave do të bëhet në prani të përfaqësuesve të autorizuar të aplikanteve, me ç'rast çdo aplikant ka të drejtë të nominojë një përfaqësues gjatë procedurës së hapjes.

Përfaqësuesi është i obliguar që të ketë autorizim me shkrim nga personi përgjegjës i personit juridik.

Ofertat do të hapen më 08.10.2015 në ora 14:00.

Kontaktet për informata

Тел: 02-2457893 и 02-2457873

Факс: 02-2457893, лок.147

*e-mail*: info@fva.gov.mk